



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0498

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “FutureBITS” SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Instalimi i Monitorit LED” me numër të prokurimit VU644-23-3917-1-2-1, me 22/09/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “FutureBITS” SH.P.K. me nr. 2023/0498 , e datës 18/07/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Instalimi i Monitorit LED” me numër të prokurimit VU644-23-3917-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 28.04.2023, Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Hapja e ofertave është bërë me 27.05.2023, Me datë 10.07.2023, AK ka publikuar B58 Njoftimin Mbi Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit “Furnizimi dhe

Instalimi i Monitorit LED” me numër të prokurimit VU644-23-3917-1-2-1.

Me datë 10.07.2023, Operatori Ekonomik “FutureBITS” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Komuna e Vushtrrisë, dhe me datë 14.07.2023, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë, eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 10.07.2023.

Me datën 18.07.2023, Operatori Ekonomik “FutureBITS” SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 498/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim-blerje. Vlera e parashikuar e kontratës: 26,537.00€

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Palët janë njoftuar palët me raportin e ekspertizës me datë: 28 korrik 2023, AK- Komuna e Vushtrrisë, nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE “FutureBITS” SH.P.K., me 28.07.2023, ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “FutureBITS” sh.p.k., të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 10.07.2023, dhe lënda të kthehet në rivlerësim *(njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit)*.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “FutureBITS” SH.P.K.

Pretendimet kryesore ankimore të OE ankues "Future BITS" sh.p.k, kanë të bëjnë kundër, njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 10.07.2023, përkatësisht arsyetimit të anulimit të aktivitetit të prokurimit ku AK-Komuna Vushtri, ka përcaktuar "...gjatë fazës së vlerësimit administrativ të ofertave me thekës të veçantë të kërkesës për Sigurim të Tenderit është konstatuar se në dosjen e tenderit në pikën 13.1 është kërkuar Sigurimi i Tenderit pa u specifikuar të dhënat tjera të domosdoshme si: vlera dhe vlefshmëri e siguria se tenderit, ndërsa në njoftimin për kontratë në nenin IV.3.4 është saktësuar se siguria e tenderit nuk është e nevojshme. AK potencon se nuk është përmbushur kërkesa nga neni 27 pika 4, citat: kërkesat e përcaktuara në FDT dhe NJK duhen të jenë identike. Kjo përben devijim substancial dhe kërkesat ligjore krijojnë pasiguri të OE-ve".

Eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i anulimit të aktivitetit të prokurimit me arsyetim të tillë në fazën pas hapjes se ofertave përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore të ligjit për Prokurim Publik.

Përkatësisht nenin 62 të LPP-së, paragrafi 1, pika 2.2, përcakton arsyet kur AK, mund ta anuloi dhe përfundoi aktivitetin e prokurimit:

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Ne rastin konkret AK- Komuna Vushtri, nuk i ka ndërmarr veprimet korrigjuese para hapjes se ofertave por pas hapjes, përkatësisht pas vlerësimit të ofertave. Po ashtu neni 57, i LPP-së, përcakton: "Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender."

Po ti referohemi pikës 13.1 të FDT-se, rezulton që AK ka aplikuar Sigurim të Tenderit, duke shenjëzuar rubrikën "PO", megjithatë nuk ka përcaktuar periudhën e vlefshmërisë së sigurimit si dhe vlerën e sigurimit të tenderit.

Për kundër kësaj OE ankues në ofertë ka bashkangjitur Sigurimin e Tenderit në vlerë prej 1000 Euro me vlefshmëri nga data 22.05.2023 deri me datë 21.08.2023.

OE ankues, sipas ankesës kundërshton edhe ofertat tjera pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit përkatësisht kërkesat e Kapacitetit Teknik dhe Profesional, ku AK në pozicionin 1 ka kërkuar: "Autorizim i nënshkruar dhe i vulosur nga prodhuesi apo distributori në emër të OE ofertues", si dhe pozicioni 2, ku si dëshmi AK ka kërkuar "Deklarate të nënshkruara dhe vulosura nga OE po ashtu deklarate të nënshkruara dhe të vulosura nga prodhuesi apo distributori".

Sipas ofertave të OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit rezulton që OE "Elektro Plus" dhe NNP "Elektro", në ofertë kanë prezantuar autorizimin nga prodhuesi i njëjtë "IANGLI",

Mendes Kozmetik Gida Elektronik, që të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit, dhe të instalojnë ekranin led, por nuk përcaktohet lloji apo modeli i ekranit sipas specifikacioneve teknike të detyrueshme, certifikatë kjo e përkthyer nga përkthyes gjyqësor, për derisa lidhur me kërkesën nr.2, për garancinë ku është kërkuar deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe prodhuesi i produktit apo distributorit të njëjtit OE të sipër përmendur në ofertë, kanë prezantuar nga një shkresë të datës 20.05.2023, "Garancion", ku përmes saj ofrohet garancion për periudhën 24 muaj garancion në emër të të njëjtit prodhues.

Përderisa OE, tjetër pjesëmarrës në procedurë të prokurimit "Lindi Markings" sh.p.k, në ofertë nuk ka prezantuar autorizim të prodhuesit fare, ndërsa garancionin e ka ofruar vet si kompani dhe jo nga prodhuesi apo distributori siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë.

Prandaj, bazuar në atë që u tha me lartë dhe bazuar në pretendimet ankimore të OE ankues, eksperti shqyrtues, propozon që lënda të kthehet në ri vlerësim t'i trajtoi oferta bazuar në dispozita ligjore, kërkesa kualifikuese, përkatësisht të krahasohen ofertat financiare të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë proces të prokurimit dhe të korrigjohen gabimet aritmetike siç përcaktohet me dispozitat e nenit 59, të LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Paneli shqyrtues e mbështet rekomandimin e

ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim ngase anulimi i këtij aktiviteti i prokurimit për këto shkaqe nuk parashihet decidivisht në dispozitat ligjore dhe është evidente se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit, por bindja e panelit shqyrtues është se duke ju referuar nenit 7 të LPP, që të gjitha ofertat të trajtohen si të barabarta, si dhe duke ju referuar nenit 57 të LPP paragrafit 1, sa i përket kërkesës për siguri të tenderit, ku kjo kërkesë si e tillë nuk është e domosdoshme por është opcionale për autoritetin kontraktues "mund", po ashtu duke e marrur parasysh edhe vlerën dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit, paneli shqyrtues konstaton se OE nuk mund të penalizohen për shkak të gabimeve të autoritetit kontraktues sepse natyra e aktivitetit të prokurimit ka të bëjë me "Furnizimi dhe Instalimi i Monitorit LED" dhe është e paarsyeshme, jo ligjore dhe e padrejtë për OE të cilët i kanë prezentuar edhe ofertat (çmimet e tyre), që ky aktivitet të anulohet.

Kështu, që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit, ti trajtoj të gjitha ofertat si të barabarta, pasi që kërkesën për siguri të tenderit nuk e ka kërkuar fare në Njoftimin për Kontratë, ndërsa në Dosje të Tenderit nuk e ka bërë të qartë as shumën dhe as kohëzgjatjen e saj, si dhe duke ju referuar nenit 56, paragrafi 3 i LPP, i cili citon: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në **njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**.", atëherë AK të mos merrë parasysh plotësimin apo jo të kësaj kërkesë dhe asnjëri OE të mos eliminohet për këtë.

Paneli shqyrtues vendos që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe konform nenit 59 të LPP të bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e të gjitha ofertave, t'i trajtoi oferta bazuar në dispozita ligjore, kërkesa kualifikuese.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 27, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat

relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - " FutureBITS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: